



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në vazhdimin e seancës së 50-të, të mbajtur më datë 22.007.2021 morri,

VENDIM

Denoncimi me numër 12-4984 / 1 i datës 29.10.2019 i parashtruar nga parashtrues i njohur REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm kompetent në lëndën me numër 12-4984 të vitit 2019 i formuar në bazë të denoncimit nr. 12-4984 / 1 të datës 29.10.2019.

Lënda me numër 12 -4984 e vitit 2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Kopje nga vendimi të dorëzohet deri te parashtruesi i denoncimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4984 e vitit 2019 e formuar në bazë të parashtresës së dorëzuar me nr. 12-4984 / 1 të datës 29.10.2019, nga parashtrues i njohur----- nga ----- . Parashtresa u ngrit për shkak të dyshimeve personale të parashtruesit për procedurë të kryer në mënyrë të paligjshme të punësimit në Drejtorinë e Policisë Financiare, në të cilën ai vetë ishte paraqitur si kandidat për punësim.

Me datë 05.07.2019, ishte publikuar shpallje për punësim në Drejtorinë e Policisë Financiare për punësim të 27 realizuesve, në të cilën shpallje parashtruesi aplikoi në të tre pozicionet e theksuara. Në parashtresë janë dhënë pikëpamje personale për rolet e anëtarëve të komisionit përzgjedhës, për rëndësinë e dhënë të përkatësisë kombëtare të kandidatëve në lidhje me pozicionet, njoftimi i dorëzuar se nuk ishte zgjedhur për punësim nuk përmban arsyetim për

moszgjidhje dhe pa këshilla juridike me qëllim të mundësisë së ankesës nga procedura. Në fakt, vërejtjet janë nga aspekti ligjor formal, dhe jo për abuzim ose vendosje të paligjshme të personave të caktuar në procedurën specifike.

Bazuar në të dhënat e përfshira në denoncimin e lëndës, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vlerësoi se denoncimi nuk përmban elemente për veprime kompetente të Komisionit Shtetëror, pas së cilës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:

Arkivi

Parashtruesi

Përgatiti: M.r K.Z, Këshilltar

Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së

